



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
**Komuna e Podujevës/ Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**



## KONTRATË

**KOMUNA E PODUJEVËS**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

**"Sankos" sh.p.k. Kaçanik, me nr biznesi: 811288134** (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

**Furnizim me veshmbathje për personelin e QKMF-së** me numër Identifikues **615-20-6938-1-3-6, nr i brendshëm: 61520135136**

### **Neni 1 Lënda**

- 1.1 Lënda e kontratës do të jetë : **Furnizim me veshmbathje për personelin e QKMF-së**  
1.2 Kontrata hynë në fuqi me 24 nëntor 2020 dhe përfundon sipas planit dinamik e që është 10 dhjetor 2020  
1.3 Afati kohor i performancës nuk mund të jetë më shumë se 3 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.  
1.4 Vendi i furnizimit do të jetë Podujevë

### **Neni 2 Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

### **Neni 3 Çmimi**

- 3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 4,925.00 €; [katërmijëenëqindnjëzetepesëeuro]  
3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

### **Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro. Në bazë të raportin nga Menaxheri i kontratës dhe komisioni i pranimit. Menaxher i kontratës është Halit Vërshefci, shef. për DSHMS, nr i tel: 044/703-087.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale te pagesës pas pranimit të tërë dërgesës

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

## **Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

## **Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtuara në Dosjen e Tenderit.

## **Neni 7 Garancioni**

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të furnizimeve.

## **Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

## **Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

## **Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

## **Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c) Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e) Falimenton; f) Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

## **Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda

periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

### Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në gjykatën kompetente në pajtim me ligjin e Kosovës.



### Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën *Shqip*<sup>1</sup> në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

*Për Operatorin Ekonomik*


*Për Autoritetin Kontraktues*

Emri:	Shefket Neziri	Emri:	Rasim Fejza
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Menaxher i DP
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	23.11.2020	Data:	23.11.2020
Vula:		Vula:	

<sup>1</sup> Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva



SPECIFIKACION

Emertimi	njesia	Femra	Meshkuj	Totali	Cmimi njësi	totali
1. Qarqaf te bardhë nga pambuku 100% per shtreter-otoman,dimensione- (2.2x1.6m)	cope			200	3,50	700,00
2. Qarqaf të bardhe nga pambuku 100% per paravana 3 kralesh,dimensione(1.8x0.8m)	Cope			100	2,50	250,00
3. Qarqaf te bardhe nga pambuku 100%per tavolina pune, dimensione- (2.0x1.4m)	cope			150	2,50	375,00
4. Mantela te bardha me mëngë te gjata(me pulla i hapur) M (Nga materiali 75%polyester,25% viscose dhe peshë 185g/m2)	cope	40	25	65	9,00	585,00
5. Mantela te bardha me mëngë te gjata (me pulla i hapur) L (Nga materiali 75%polyester,25% viscose dhe peshë 185g/m2)	cope	50	30	80	9,00	720,00
6. Mantela te bardha me mëngë te gjata (me pulla i hapur) XL (Nga materiali 75%polyester,25% viscose dhe peshë 185g/m2)	cope	30	25	55	9,00	495,00
7. Mantela te kalter me mëngë te gjata (me pulla i hapur) M (Nga materiali 75%polyester,25% viscose dhe peshë 185g/m2)	cope	3	2	5	9,00	45,00

8,	Mantela te kalter me mëngë të gjata (me pulla i hapur) L (Nga materiali 75%polyester,25% viscose dhe peshë 185g/m2)	Cope	5	5	10	9,00	90,00
9,	Mantela te kalter me mëngë të gjata (me pulla i hapur) XL (Nga materiali 75%polyester,25% viscose dhe peshë 185g/m2)	cope	5	5	10	9,00	90,00
10.	Uniforme per vozites,ngjyre e kalter qielli(pallto+pantollona) L (Nga materiali 75%polyester,25% viscose dhe peshë 185g/m2)	cope		7	7	17,00	119,00
11,	Uniforme per vozites ngjyre e kalter qielli(pallto+pantollona) XL (Nga materiali 75%polyester,25% viscose dhe peshë 185g/m2)	cope		8	8	17,00	136,00
12.	Uniforma per roje ngjyre e kalter e mbyllet(pallto+pantallona)L (nga materiali 65% polyester dhe 35%pambuk)	cope		4	4	17,00	68,00
13,	Uniforma per roje ngjyre e kalter e mbyllet(pallto+pantollona)XL(nga materiali 65% polyester dhe 35%pambuk)	cope		6	6	17,00	102,00
14.	Mbathje-kllompe te bardha, (Materiali 100% lëkurë, pjesa e poshtme duhet të jetë prej gome me trashësi prej 4-6 cm)	pale	138	92	230	5,00	1.150,00
	Cmimi total						4.925,00

Verejtje: Ne gjepin e siperm te uniformes te shkruhet QKMF-Podujeve dhe Stema e shendetesise i